

V E N D I M

Nr. 830, datë 28.12.1998

PËR KRITERET E LLOGARITJES SË VLERËS VJETORE TË QIRASË SË TOKAVE BUJQËSORE, PYJORE, ME BIMË PYJORE, LIVADHEVE DHE KULLOTAVE, PASURI SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave, pasuri shtetërore”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kriteret për llogaritjen e vlerës vjetore të qirasë së tokave të jenë:
 - a) të ardhurat aktuale mesatare, të realizuara nga kulturat bujqësore të tre viteve të fundit, për të njëjtin nivel pjellorie të saj. Vlera e qirasë të jetë 30 për qind e të ardhurave neto;
 - b) largësia e tokës bujqësore nga qendra urbane, si më poshtë:
Për çdo 1 km pas distancës prej 10 km vlera e qirasë së tokës bujqësore do të zbritet në 1 për qind.
2. Në çdo rast, vlera fillestare e ankandit të qirasë së tokës bujqësore, pasuri shtetërore, e bazuar në pjellorinë e tokës, sipas vlerësimit të bërë nga Instituti i Studimit të Tokave, nuk duhet të jetë më e ulët se:

Kategoria e tokës	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII-IX
Vlera e qirasë lekë/ha	30 000	26 000	22 000	18 000	14 500	11 500	7 000	6 000

Këto vlera janë për vitin 1998. Për vitet pasardhëse bëhet indeksimi i tyre, në përputhje me të dhënat e fillimit të vitit të treguesve makroekonomikë, të publikuar nga organi shtetëror i autorizuar (INSTAT).

3. Vlera fillestare e ankandit të tokave pyjore dhe me bimësi pyjore është e barasvlershme me kategorinë VIII-X të tokave bujqësore.

4. Kriteret e llogaritjes së vlerës vjetore të qirasë së livadheve dhe të kullotave të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 6.6.1994 “Për tarifat e kullotjes në fondin kullor të kullotave e pyjeve në administrimin e drejtorive të shërbimit pyjor të kullotave dhe të komunave”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

